SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL
LËVIZJE PARALELE OSE NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

PROCEDURA

Pranim në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit të mesëm drejtues.

KATEGORIA

Kategoria e Mesme Drejtuese

POZICIONI

Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë,Pyjeve, Mjedisit, Performancës dhe Statistikës- Klasa II-2

Në zbatim të Nenit 26 të Ligjit nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*" (i ndryshuar), si dhe të kreut II dhe III të Vendimit Nr.242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me VKM nr.748, datë 19.12.2018 "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*", Bashkia Elbasan shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjen në detyrë ose pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

- ***Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë,Pyjeve, Mjedisit, Performancës dhe Statistikës- Klasa e pagës II-2***

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakant, ata janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të gjitha procedurat (*lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil*) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve: 17.10.2022 **LËVIZJE PARALELE**
Afati për dorëzimin e dokumenteve: **NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL 22.10.2022**

I. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. ***Për pozicionin e punës Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Performancës dhe Statistikës.***

Drejton dhe organizon punën e drejtorisë dhe të sektorëve në varësi. Harton dhe propozon politika, programe dhe plane veprimi në fushën e bujqësisë, pyjeve, mjedisit, performancës dhe statistikës. Koordinon hartimin dhe zbatimin e strategjive lokale për zhvillimin rural dhe mbrojtjen e mjedisit. Mbikëqyr administrimin dhe monitorimin e fondit pyjor dhe kullosor në administrim të bashkisë.
Ndjek zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor. Siguron mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore për nevojat e bashkisë. Përgatit raporte periodike mbi treguesit e performancës dhe realizimin e objektivave strategjikë. Bashkëpunon me institucionet qendrore, rajonale dhe organizatat e tjera në fushat përkatëse. Monitoron zbatimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore në fushat që mbulon drejtoria. Jep udhëzime dhe orientime për personelin në varësi. Përgjigjet për ligjshmërinë dhe cilësinë e akteve të përgatitura nga drejtoria.
Mban përgjegjësi për realizimin e objektivave dhe treguesve të performancës së drejtorisë.
Mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave statistikore dhe raporteve të përgatitura.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë proçedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-2;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si vijon:

Për pozicionin e punës Drejtor në *Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Performancës dhe Statistikës*

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në biologji- kimi, bujqësi, mjedis, pyje, ekonomi, administrim publik ose fusha të ngjashme. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në pozicione drejtuese.
3. Të kenë njohuri njohuri të legjislacionit për mjedisin, pyjet, bujqësinë dhe administrimin publik.
4. Të kenë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet, për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi.
5. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi dhe të punës në grup.
6. Të kenë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe proçedurave të reja.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi.
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 17.10.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19.10.2026,** Sektori Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkise Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
b) Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
c) Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
d) Ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
e) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
f) Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të intereresave"*;
g) Ligjin nr. 119/2014, *"Për të drejtën e informimit"*;
h) Ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;
i) Ligjin nr. 10431/2011 "*Për mbrojtjen e Mjedisit*", i ndryshuar;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individale në punë në rastet kur proçesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë.**

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për proçesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail-it) për datën e saktë të shpalljes së fituesit dhe rezultatet.

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, nuk plotësohet në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, dhe nëse as kjo procedure nuk plotësohet vazhdon procedura për pranim jashtë shërbimit civil. Të dyja këto procedura zhvillohen njëkohësisht.
Ky informacion do të merret në faqen e internetit të Bashkise Elbasan dhe stendat e informimit qytetar,
Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin institucion apo institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kriteret për ngritje në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

1. Të jenë nëpunës civil të konfirmuar;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
4. Të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si vijon:

Për pozicionin e punës Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Mjedisit, Performancës dhe Statistikës

1.1.Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në biologji- kimi, bujqësi, mjedis, pyje, ekonomi, administrim publik ose fusha të ngjashme. *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

1.2.Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në pozicione drejtuese.

1.3.Të kenë njohuri njohuri të legjislacionit për mjedisin, pyjet, bujqësinë dhe administrimin publik.

1.4.Të kenë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet, për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi.

1.5.Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi dhe të punës në grup.

1.6.Të kenë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe proçedurave të reja.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti me zarf të mbyllur pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 22.10.2026

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **01.11.2026**, Sektori Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkise Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
b) Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
c) Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
d) Ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
e) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
f) Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të intereresave"*;
g) Ligjin nr. 119/2014, *"Për të drejtën e informimit"*;
h) Ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për proçesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore- Bashkia Elbasan, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të "Agjencisë Kombëtare të Punësimit" (portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email-it).

Pa cenuar të drejtën e ankimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi, kandidatët kanë të drejtë që të ankohen me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e rezultatit. KPP-ja merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve dhe, kur është rasti, bën korrigjimin e listës së fituesve të shpallur. Vendimi dhe, kur është rasti lista e korrigjuar, shpallet menjëherë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Elbasan.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të periudhës së ankimimit, Institucioni Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Elbasan Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.